

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTER
KËSHILLI BASHKIAK**

Komisioni i Përherëshëm i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 07 datë 30/10 2025

Nr. _____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. _____ datë 31/10 2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin:

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB-NË NR.86 DATË 12.12.2024 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027 DHE BUXHETIT VJETOR 2025”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe VKB nr.86 datë 12.12.2024 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025”, i ndryshuar”

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

1. Bashkia planifikon të krijojë një sistem të unifikuar digjital që mbledh, analizon dhe menaxhon në kohë reale të gjitha të ardhurat vendore, me integrim të plotë ndërinstitucional dhe transparencë për qytetarin.

Qëllimi kryesorë është eliminimi i arkëtimit manual dhe gabimeve njerëzore, krijimi i një portali qendror “Taksat e Mia – Bashkia Gjirokastrë” për qytetarët dhe bizneset, kryqëzimin automatik të dhënave me OSSHE, Ujësjiellës, Tatime, Hipotekë dhe Banka, monitorim në kohë reale të performancës financiare të çdo njësie administrative dhe rritje e mbledhjes me 25–30% brenda 2 viteve përmes formalizimit dhe efikasitetit.

Përfitimet

- Transparencë & besim: çdo faturë, pagesë, anulim ka gjurmë; raporte “live”.
- Të ardhura pa rritur taksat: rritje baze (zbulojmë të padeklaruarit), ulje rrjedhjesh, pagesë më e shpejtë.
- Kosto më e ulët operimi: më pak manualitet, më pak sportele, më pak gabime.
- Politikë fiskale më e drejtë: tarifim sipas përdorimit/zonës, jo mesatare të “verbër” konformë paketës fiskale.
- Përvoja e qytetarit: portal “Taksat e Mia” + pagesa online + ankim elektronik → më pak kohë/burokraci.
- Analitikë & parashikim: dimë ku nuk funksionon, ku mungon formalizimi; lidhje e drejtpërdrejtë me buxhetimin vjetor.

2) Në kuadër të përmirësimit të monitorimit urban dhe të ruajtjes së pastërtisë dhe rendit në hapësirat publike, parashikohet vendosja e kamerave të sigurisë në disa pika të identifikuara si problematike në territorin e Bashkisë Gjirokastrë. Qëllimi i ndërhyrjes është monitorimi i pikave të nxehta ku konstatohet hedhje e mbetjeve pa kriter, jashtë koshave të mbetjeve dhe në kundërshtim me rregullat e pastrimit urban, • Ruajtja e shesheve publike, parqeve dhe hapësirave të frekuentuara nga qytetarët, ku shpesh dëmtohen elementë të infrastrukturës urbane, • Mbikëqyrja e ambienteve në varësi të Bashkisë, përfshirë institucionet kulturore, qendrat komunitare, dhe hapësirat e shërbimeve sociale.

Përfitimet e vendosjes së kamerave është • Rritja e ndërgjegjësimit qytetar për respektimin e rregullave të pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike, • Mundësimi i identifikimit të shkelësve dhe ndjekja e procedurave administrative për parandalimin e përsëritjes së sjelljeve të dëmshme, • Sigurimi i një mjedisi më të pastër, më të sigurt dhe më të kontrolluar, në funksion të mirëqenies së komunitetit dhe të vizitorëve. Propozimi është të miratohet vendosja e një numri të përshtatshëm kamerash në pikat e identifikuara nga shërbimi i pastrimit dhe inspektoriat i vendor

gjithashtu të parashikohet mirëmbajtja dhe administrimi i sistemit të kamerave nga strukturat përkatëse të Bashkisë, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe sektorin e IT-së.

Kjo ndërhyrje përfaqëson një hap konkret drejt menaxhimit më efikas të territorit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së komunitetit. Fondi i parashikuar për këtë zë buxhetor parashikohet në vlerën 1,200,000 lekë

3) Në kuadër të përmirësimit të kushteve të mësimdhënies dhe të punës në institucionet publike të qytetit, parashikohet blerja e 8 kondicionerëve, të cilët do të shpërndahen si më poshtë:

a) Qendra Kulturore e Fëmijëve (QKF) – 5 kondicionerë

Aktualisht, 5 nga klasat ku zhvillohen aktivitete edukative dhe artistike nuk janë të pajisura me sistem ngrohje/freskimi. Pajisja me kondicionerë do të sigurojë një ambient të përshtatshëm për fëmijët gjatë gjithë vitit, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e aktiviteteve dhe mirëqenien e pjesëmarrësve.

b) MZSH Gjirokastër (Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi) – 3 kondicionerë

Ambientet e shërbimit të MZSH, përfshirë hapësirat e punës dhe pritjes, kanë nevojë për përmirësim të kushteve termike. Pajisja me kondicionerë do të ndihmojë në garantimin e një mjedisi funksional dhe të sigurt për stafin dhe qytetarët që marrin shërbim.

Blerja e kondicionerëve përfaqëson një investim të arsyeshëm në përmirësimin e infrastrukturës publike. Përfituesit janë fëmijët, edukatorët, stafi i emergjencave dhe qytetarët që ndërveprojnë me këto institucione.

Fondi i parashikuar për këtë zë buxhetor parashikohet në vlerën 575,000 lekë.

Projekte ekzistuese

1. Për sezonin futbollistik 2025-2026 ekipi i futbollit Luftëtari u ngjit një Kategori pasi doli fitues i grupit B në kategorinë e Dytë në sezonin 2024-2025. Një fillim i ri në kategorinë e parë ndryshoi shumë, si në aspektin organizativ, atë administrativ dhe finaciar. Për këtë arsye lind domosdoshmëria për parashikime të reja shtesë për marrjen e masave për funksionimin e akademisë pasi ky ndryshim ka ndodhur në mes të vitit 2025. Këto ndryshime nevojiten për të ardhmen për rezultate më të mira për ekipin e Luftëtarit dhe për sportdashësit e qytetit tonë. Nga analiza e rezulton se;

a) Faza përgatitore për sezonin 2025-2026 filloi në muajin Korrik dhe u grumbulluan shumë lojtarë me eksperiencë të ndryshme nga ekipe të kategorisë së parë. Kontratat dhe pagesa të lojtarëve të grumbulluar ishin më të larta nga një vit më parë. U zhvilluan faza përgatitore në qytetin e Ersekës për 12 ditë kjo taktikë stërvitore e pandjekur më parë solli efekte financiare shtesë.

b) Kampionati i Kategorisë së parë filloi në 23 Gusht dhe ku morën pjesë 10 ekipe me 33 ndeshje nga të cilat 17 ishin jashtë fushës së Gjirokastër në qytete të ndryshme të vendit, kjo solli kosto

financiare përtej parashikimeve, pra kostot e transportit janë më të larta dhe akomodimi i rritur trefish në krahasim me kampionatin e kategorisë së dytë.

c) Shpenzimet operative gjatë vitit 2025 janë ritur në masë të konsiderueshme, një nga zërat si ajo e mirëmbajtjes së fushës është rritur ndjeshëm.

d) Akomodimi për trajnerin dhe futbollistët jo gjirokastrit është rritur gjatë vitit 2025, pasi në kontratat e tyre janë të përfshira edhe facilitate të tjera të akomodimit.

e) Trajtimi me ushqim i futbollistëve do të jetë në ato nivele si vitin e kaluar. Këtu paraqiten edhe detyrime të pa mbyllura nga viti 2024.

f) Pagat e personelit, trajnereve dhe lojtarëve janë paguar rregullish dhe në kohë dhe nuk paraqiten detyrime të prapambetura.

g) Tatimet dhe sigurimet janë paguar, nuk rezultojnë detyrime të prapambetura.

h) Transporti vazhdon të jetë një zë i paguar pjesërisht, rezultojnë detyrime të prapambetura nga viti 2024.

(Bashkëngjitur analiza)

Me qëllim likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe vijimësinë e funksionimit normal të akademisë parashikohen 10,000,000 lekë mbështetje financiare.

2. Në kuadrin e ndryshimeve të prioritetit të politikave buxhetore rezultojnë e nevojshme financimi i projekteve të investimeve me përqindje më të lartë realizimi në terren kundrejtë projekteve të cilat kanë një përqindje shumë të ulët apo aspak në terren si;

a) "Sistemi asfaltim rruga Taroninë-Zhulat" financim në vlerën 13,341,999 lekë

b) "Rivitalizim i hapësirave publike rreth stadiumit" financim në vlerën 7,523,730 lekë

c) "Mbikqyrje për objektin "Rikonstruksioni i rrugës "Baba Selimi" Zinxhira" në vlerën 884,919 lekë.

d) "Mbikqyrje për objektin "Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe shkallës së emergjencës dhe dhomës

teknike në shkollën 9 - vjeçare "Urani Rumbo" në vlerën 879,682 lekë.

e) Veprime me ASHK-në për legalizim dhe kalim pronësi të aktiveve të paluajtshme, në vlerën 2,000,000 lekë.

✚ Shpenzimet koherente

1. Nga analiza e kreditorëve rezultojnë financim për proceset gjyqësore në vlerën 1,600,000 lekë. Në kuadrin e menaxhimit të financave është ruajtur me prioritet moskrijimi i detyrimeve të krijuara rishtaz përse i përketë faturave, por nuk mund të shprehet e njëjta gjë për shpenzimet gjyqësore, shpenzime të cilat nuk varen drejtë përdrejtë nga menaxhimi i financave të bashkisë.

2. Në kuadrin e aktiviteteve sportive Festivali i Shahut është një event i përvitshëm sportive i organizuar nga Federata Shqiptare e Shahut në bashkëpunim me pushtetin vendor duke synuar promovimin e vlerave të sportit dhe kulturës së shahut në qytetet kryesore të vendit. Federata Shqiptare e Shahut ka sjellë propozimin për zhvillimin e aktivitetit sportive në Gjirokastrë. Nëpërmjet VKB-së nr 36, datë 30.04.2025, është mbështetur me fond financiar produkti V813AAB në vlerën 1,340,000 lekë. Me qëllim zhvillimin e aktivitetit sportiv sipas projektit të praqitur nga Federata Shqiptare e Shahut lind domosdoshmëria e parashikimit të fondit financiar në masën 338,500 lekë për financimin e plot të aktivitetit.

3. Në mbështetje të festave të fundvitit parashikohen shpenzime operative për zëra buxhetor “Kartolina urimi, zarfe dhe letra adezive” në vlerën 262,500 lekë dhe album fotografik “Gjirokastra” në vlerën 500,000 lekë.
4. Pas rakordimit me drejtoritë e kopshteve dhe çerdheve, për fëmijët që kanë përfunduar kopshtin dhe çerdhen në vitin 2025, lind domosdoshmëria për çeljen e fondeve për të bërë të mundur kthimin e paradhënies.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, Udhëzimi nr 09. Date 23.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe VKB-së nr.86 datë 12.12.2024 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit vjetor 2025”, propozohen ndryshime në buxhetin vjetor 2025 si më poshtë vijon;

Pakësohet

Programi AC115 Kap.1 Art 602 me kod projekti V813AAB “*Paga.kontr.eksp. jashtem.Kampionatin Kombetar të Shahut*” në vlerën 840,000 lekë.

Programi AC115 Kap.5 Art 602 me kod projekti V813AAB “*Paga.kontr.eksp. jashtem.Kampionatin Kombetar të Shahut*” në vlerën 500,000 lekë.

Programi AE115 Kap.5 Art 231 me kod projekti P626AAH “*Rikualifikim i hapësirave publike në tregun ekzistues fruta perimeve, godinës për treg të brendshëm*” në vlerën 35,000,000 lekë.

Programi AD115 Kap.1 Art 231 me kod projekti P091AAD në vlerën 5,806,331 lekë

Programi AF115 Kap.1 Art 602 me kod projekti V912AAB (*kancelari*) në vlerën 333,100 lekë.

Shtohet

Programi AA115 Kap.5 Art 231 (*Shpenz.Mjete dhe pajisje te tjera teknik. Sistem për menaxhimin e të ardhurave*) me kod projekti V112AAC në vlerën 2,000,000 lekë.

Programi AD115 Kap.5 Art 231 (*Kamera për monitorim të ambienteve të jashtme*) me kod projekti V314AAB në vlerën 1,200,000 lekë.

Programi AF115 Kap.5 Art 231 (*Shpenzime orendi zyre “kondicionerë”*) me kod projekti V912AAF në vlerën 360,469 lekë.

Programi AD115 Kap.05 Art 231 (*Shpenzime orendi zyre “kondicionerë”*) me kod projekti V328AAC në vlerën 214,531 lekë.

Programi AC115 Kap.5 Art 604 me kod projekti V813AAC në vlerën 4,193,669 lekë.

Programi AC115 Kap.1 Art 604 me kod projekti V813AAC në vlerën 5,806,331 lekë.
 Programi AE115 Kap.5 Art 231 me kod projekti P452AAZ në vlerën 13,342,000 lekë.
 Programi AE115 Kap.5 Art 231 me kod projekti P626ABF në vlerën 7,523,730 lekë.
 Programi AE115 Kap.5 Art 231 me kod projekti P626AAH "Mbikqyrje për objektin
 "Rikonstruksioni i rrugës "Baba Selimi" Zinxhira" në vlerën 884,919 lekë.
 Programi AF115 Kap. 5 Art 231 me kod projekti P912AAC "Mbikqyrje për objektin
 "Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe shkallës së emergjencës dhe dhomës teknike në
 shkollën 9 - vjeçare "Urani Rumbo" në vlerën 879 682 lekë
 Programi AA115 Kap.5 Art 602 me kod projekti V614AAC (*Veprime me ASHK-në*) në
 vlerën 1,160,000 lekë.
 Programi AA115 Kap.1 Art 602 me kod projekti V614AAC (*Veprime me ASHK-në*) në
 vlerën 840,000 lekë.
 Programi AA115 Kap.5 Art 602 me kod projekti V111AAG në vlerën 1,600,000 lekë.
 Programi AA115 Kap.5 Art 602 me kod projekti V360AAA (Kartolina e fundvitit, zarfe,
 letra adeziv) në vlerën 262,500 lekë.
 Programi AA115 Kap.5 Art 602 me kod projekti V360AAA (Dhurata) në vlerën 200,000
 lekë.
 Programi AC115 Kap.5 Art 604 me kod projekti V813AAB në vlerën 1,678,500 lekë.
 Programi AF115 Kap.1 Art 606 me kod projekti V912AAD (*Kthim kuote paradhënies*
(femije qe frekuentojne kopeshit me dreke) në vlerën 273,100 lekë.
 Programi AF115 Kap.1 Art 606 me kod projekti V043AAC (*Kthim kuote paradhënies*
(femije qe frekuentojne çerdhe) në vlerën 60,000 lekë.

Në kuadrin e menaxhimit të burimeve financiare, fondet e përdorura nga projekti
 P091AAD në vlerën 5,806,331 lekë dhe nga projekti P626AAH "Rikualifikim i hapësirave
 publike në tregun ekzistues fruta perimeve, godinës për treg të brendshëm" në vlerën
 35,000,000 lekë do të financohen në buxhetin 2026.

Drejtoria / Sektori përgjegjës :

Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak,
 sipas pershkrimeve ligjore dhe sa here ai e shikon te nevojshme.

Impakti social / grupet që preken:

Ky projekt vendim impakton te gjitha shtresat dhe kategorite e komunitet te bashkise Gjirokaster si dhe zhvillimin ekonomik te krejt territorit te kesaj bashkie.

A është objekt i konsultimit publik:

PO

Komisioni i Përhershëm i i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”

i mbledhur me datën 30 / 10 / 2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. _____ datë / ____ 2025, relacionit e dokumentat shoqërues në me propozimin:

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB-NË NR.86 DATË 12.12.2024 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 DHE BUXHETIT VJETOR 2025”

paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- ☒ a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- ☒ b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - ✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “ _____“
 - ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “ _____“
 - ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “ _____“
 - ✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “ _____“

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në
proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit


(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit

Datë 30 /10 / 2025